

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti juridik
Titulli i lëndës:	Fillet e së drejtës
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	E obligueshme
Viti i studimeve:	I
Numri i orëve në javë:	3 + 2
Vlera në kredi – ECTS:	8
Koha / lokacioni:	Kabineti Nr. 18, Kati V, e martë 12:00 – 14:00
Mësimdhënësi i lëndës:	Dr. Gjyljeta Mushkolaj, Prof. Asoc.
Detajet kontaktuese:	gjyljeta.mushkolaj@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	<p>Në pjesën e parë, studentët njihen me rolin e Teorisë së së të drejtës në shkencat juridike në përgjithësi dhe në studimet juridike. Shpjegohen teoritë më të rëndësishme për origjinën e shtetit dhe të së drejtës dhe për shkencat juridike në përgjithësi. Më pastaj analizohet struktura e shtetit, organet dhe funksionet e tij. Në vijim diskutohen elementet e shtetit dhe trajtat e tij. Në pjesën e dytë paraqitet koncepti i normave juridike, ndarja e normave juridike bazuar në kriteret e ndryshme si dhe struktura e normave juridike. Analizohet koncepti i marrëdhënieve juridike dhe diskutohen elementet bazë të marrëdhënies juridike (subjektët e së drejtës, objekti i së drejtës, e drejta subjektive dhe detyrimi juridik). Shpjegohet koncepti i aktit juridik dhe diskutohen burimet e së drejtës (kushtetuta, ligji, aktet shtetërore nënligjore, aktet e personave publik dhe privat, e drejta zakonore, si dhe shkenca juridike). Pjesa e tretë paraqet studimin e konceptit të sistemit juridik dhe diskutohen njësitë themelore të sistemit juridik (norma juridike, institutet e së drejtës, degët e së drejtës, grupet e së drejtës). Më tutje, shqyrtohen teknikat themelore të interpretimit, mënyrat e zgjidhjes së çështjeve rreth zbrazëtirave juridike. Së fundi, shqyrtohen teori të ndryshme në lidhje me esencën dhe strukturën e së drejtës (teorisë së të drejtës natyrore, shkollën historike, teori e pastër e ligjit, etj).</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Qëllimet e studimit të Filleve të së drejtës është që studentit të:</p> <ul style="list-style-type: none"> identifikojë, kuptoj, emërtoj dhe të dalloj konceptet themelore të të drejtës;

	<ul style="list-style-type: none"> • të kuptoj thelbin dhe formën, si dhe elementet bazë, organet dhe funksionet e shtetit; • të identifikoj dhe përshkruaj institutet themelore, parimet, funksionet dhe vlerat e së drejtës; • të dalloj dhe të identifikojë llojet kryesore të burimeve të së drejtës; • të grupojë dhe të identifikojë elementet e sistemit juridik; • të njihet me qasjet themelore teorike ndaj shtetit dhe të së drejtës; • të emërtojë dhe të përshkruaj teknikat themelore të së drejtës. 		
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Pas përvetësimit me sukses të kursit, studenti do të :</p> <ul style="list-style-type: none"> • aftësohet për të identifikuar dhe përmbledh faktet dhe elementet kryesore të së drejtës; • zotëroj aftësinë e argumentimit sistematik dhe kuptimplotë të qëndrimeve të veta; • krijojë bazat e aftësisë së arsyetimit ligjor; dhe • zotërojë bazat e shprehjes ligjore të shkruar. 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	3	3	9
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	9	15	135
Përgaditja përfundimtare për provim	15		15
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	2	4
Projektet,prezentimet ,etj	2	2	4
Totali			261
Metodologjia e mësimdhënies:	<p>Sesionet e lëndës përbëhen nga ligjëratat, ushtrimet, diskutimet në klasë dhe një prezantim gojor pesë minutësh nga secili student gjatë semestrit. Studentët pritët të kenë lexuar materialet e caktuara para orëve</p>		

	të ligjëratave, të arrijnë me kohë dhe të jenë të përgatitur për të marrë pjesë plotësisht në diskutimet në klasë. Studentët kërkohet të marrin pjesë në të gjitha ligjeratat dhe ushtrimet, sepse kollokuimi dhe provimi përfundimtar do të përfshijë pyetje në lidhje me materialet e mbuluara vetëm në orët e ligjëratave dhe të ushtrimeve, si dhe materiale të caktuara si detyrë gjatë orëve të ligjëratave dhe të ushtrimeve. Pjesëmarrja në ligjërata dhe në ushtrime është e detyrueshme dhe do të mbahet evidencë e prezencës së studentëve.
Metodat e vlerësimit:	Nota përfundimtare në këtë lëndë do të përcaktohet si vijon: 10% - Pjesëmarrja aktive (nëpërmjet të diskutimeve) në ligjërata dhe në ushtrime 10% - Prezantimi gojor 10% - Një ese prej pesë faqesh e dorëzuar para prezantimit gojor (në të njëjtën temë) 30% - Kollokuimi 40% - Provimi final
Literatura	
Literatura bazë:	Dr.sc.Osman Ismaili: FILLET E SË DREJTËS, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, Prishtinë, 2011;
Literatura shtesë:	Luan, Omari. "Parime dhe institucione të së drejtës publike." (2004). Luan, Omari. "Shteti i së drejtës." (2002). MacCormick, Neil. <i>Institutions of law: an essay in legal theory</i> . OUP Oxford, 2007. Kelsen, Hans. <i>General theory of law and state</i> . Vol. 1. The Lawbook Exchange, Ltd., 1945. Kelsen, Hans. <i>Pure theory of law</i> . Univ of California Press, 1967. Hart, Herbert Lionel Adolphus. "The Concept of Law, with a postscript." (1994). D'amato, Anthony A. <i>Introduction to law and legal thinking</i> . Transnational Pub Inc, 1996. Visković, Nikola: <i>Teorija države i prava</i> , Zagreb, 2006. Centar za dopisno obrazovanje Birotehnika
Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet

Java e parë:	Nocioni i Filleve të së drejtës Raporti ndërmjet filleve të së drejtës dhe shkencave të tjera juridike e shoqërore Metodat e studimit të Filleve të së drejtës
Java e dytë:	Nocioni i shtetit Elementet e shtetit Shtetësia, kuptmi, rëndësia dhe mënyrat e fitimit të saj
Java e tretë:	Raporti i shtetit dhe i së drejtës me dukuritë tjera shoqërore Zhvillimi i shtetit dhe i së drejtës Ndryshimet në shtet dhe të drejtë
Java e katërt:	Shteti si organizatë dhe aparat Llojet e organeve shtetërore
Java e pestë:	Llojet e trajtave shtetërore Trajta e sundimit Nocioni i shefit të shtetit <ul style="list-style-type: none"> • Monarkia dhe llojet e saj • Nocioni i Republikës
Java e gjashtë:	Nocioni i trajtës së rregullimit shtetëror Shteti i përbërë <ol style="list-style-type: none"> a. <i>Konfederata</i> b. <i>Federata</i> <ul style="list-style-type: none"> • Shteti i thjeshtë (unitar) <ol style="list-style-type: none"> a. <i>Nocioni i centralizimit</i> b. <i>Nocioni i decentralizimit</i> • Unioni real dhe personal • Protektorati
Java e shtatë:	<ul style="list-style-type: none"> • Parimi i ndarjes së pushtetit shtetëror <ol style="list-style-type: none"> a. <i>Sistemi presidencial</i> b. <i>Sistemi parlamentar</i> c. <i>Sistemi i përzier</i> • Parimi i unitetit të pushtetit shtetëror
Java e tetë:	Katër teoritë më të rëndësishme të së drejtës <ul style="list-style-type: none"> • E drejta natyrore • Pozitivizmi ligjor • Realizmi ligjor • Studimet kritike të së drejtës
Java e nëntë:	Nocioni i rendit juridik Nocioni i normës juridike Llojet e normave juridike Vlefshmëria e normës juridike në territor (hapësirë) Vlefshmëria kohore e normave juridike Fuqia prapavepruese (retroaktive) e normave juridike Struktura e normës juridike

Java e dhjetë:	<p>Nocioni i marrëdhënieve juridike</p> <p>Elementet e marrëdhënies juridike</p> <ul style="list-style-type: none"> • Subjektet e së drejtës (Personat fizikë dhe Personat juridik) • Autorizimi juridik (E drejta subjektive, Keqpërdorimi i autorizimit, Keqpërdorimi i së drejtës subjektive, Kompetenca dhe Keqpërdorimi i kompetencës) • Obligimi juridik (detyrimi) <p>Gjendja juridike (statusi)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Objekti i së drejtës <p>Faktet juridike</p> <p>Parashkrimi dhe dorëmbajtja</p>
Java e njëmbëdhjetë:	<p>Nocioni i aktit juridik</p> <p>Elementet e aktit juridik</p> <p>Akti i përgjithshëm juridik si burim i së drejtës (Kushtetuta, Ligji, Aktet e përgjithshme juridike me fuqi nënligjore)</p> <p>Rëndësia e zakoneve dhe e shkencës juridike</p> <p>Akti individual juridik</p>
Java e dymbëdhjetë:	<p>Ligjshmëria</p> <p>Fuqia juridike</p> <p>Mjetet juridike</p> <p>Sanksionet ndaj kundërligjshmërisë</p> <p>Plotfuqishmëria</p> <p>Përmbartimi (ekzekutimi)</p>
Java e trembëdhjetë:	<p>Nocioni i zbatimit të së drejtës</p> <p>Procesi i zbatimit të normës juridike</p> <p>Provat juridike</p> <p>Supozimet dhe fiksionet</p> <p>E drejta pozitive</p>
Java e katërbëdhjetë:	<p>Nocioni i interpretimit të së drejtës</p> <p>Interpretuesit e së drejtës</p> <p>Procedura e interpretimit</p> <p>Interpretimi sipas teknikes së interpretimit (Interpretimi gjuhësor, interpretimi ekstensiv dhe interpretimi restriktiv, interpretimi i lidhur dhe interpretimi i lirë, interpretimi subjektiv dhe objektiv, Interpretimi statik dhe evolutiv, dhe Interpretimi logjik, interpretimi sistematik, interpretimi historik, interpretimi teleologjik).</p>
Java e pesëmbëdhjetë:	<p>Nocioni i sistemit të së drejtës</p> <p>Elementet e sistemit të së drejtës (Institucionet juridike, degët juridike, lëmenjtë juridike, e drejta ndërkombëtare dhe e drejta e brendshme, e drejta materiale dhe e drejta formale, e drejta</p>

	publike dhe e drejta private)
--	-------------------------------

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
--

E gjithë puna e studentit duhet të jetë e pavarur. Studentët duhet të njihen me Kodin etik të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", i cili kërkon që të gjithë, studentët dhe personeli akademik të ruajnë standardet më të larta të ndershmërisë dhe integritetit akademik. Mashtrimi, plagjiatura, gënjeshtria dhe vjedhja janë rreptësisht të ndaluara. Të gjitha shkeljet e Kodit Etik do t'i raportohen Komisionit disiplinor.
--